



URDHRI I PSIKOLOGUT ZGJEDHJE 2021



Urdhri i Psikologut

Zgjedhje 2021

Rregullat që duhen ndjekur lidhur me mënyrën e votimit:

- Çdo psikolog, i cili është anëtar aktiv i Urdhrit të Psikologut, pra që ka shlyer kuotizacionin për vitin 2021 ka të drejtë për të votuar.
- Orari i votimit do të jetë 10:00 - 15:00.
- Votimi është vetjak e nuk mund të delegohet tek persona të tjerë.
- Çdo anëtar duhet të paraqesë Kartën e Anëtarësisë (si praktikant apo i licencuar në varësi të statusit) përpara komisionit përpara se të votojë.
- Nuk lejohen të përdoren nga votuesit telefoni apo pajisje të tjera elektronike gjatë momentit të votimit.
- Çdo anëtar, pasi të regjistrohet nga Komisioni i Regjistrimit, do të pajiset me 4 (katër) fletë të veçanta (të dallueshme sipas ngjyrave) votimi (1 për zgjedhjen e Presidentit dhe 3 për zgjedhjen e anëtarëve të Këshillit Kombëtar sipas kategorive).
- Pas marrjes së fletëve votuesi i drejtohet dhomës së fshehtë dhe ushtron të drejtën e votës për kandidatët e tij/saj të preferuar me vullnet të lirë e në mënyrë të fshehtë.
- Do të konsiderohen si vota të vlefshme vetëm ato vota, ku votuesi ka shënuar brenda kuadrantit të përcaktuar shenjën " X " ; " + " ose " - ", si dhe nuk ka bërë asnjë shënim tjetër mbi fletë.
- Në rast se është votuar për më shumë apo më pak kandidatë në një fletë votimi, nga sa është e parashikuar në rregullore, si dhe nga sa është e sqaruar edhe në fletën e votimit, atëherë vota do të shpallet e pavlefshme nga Komisioni i Numërimit.
- Pasi votuesi ka plotësuar të 4 fletët e votimit, do i palosë ato në mënyrë që pjesa e dukshme të jetë nga vula e vendosur nga Komisioni, do i depozitojë ato në 4 kutitë e votimit të vendosura në qendër të dhomës së votimit, secila fletë në kutinë e saj të posaçme dhe më pas do të largohet nga qendra e votimit.

Zyra Juridike

